

**SUPREME COURT OF KOSOVO
GJYKATA SUPREME E KOSOVËS
VRHOVNI SUD KOSOVA**

**KOSOVO PROPERTY AGENCY (KPA) APPEALS PANEL
KOLEGJI I APELIT TË AKP-së
ŽALBENO VEĆE KAI**

GSK-KPA-A-59/13

Prishtinë, 17 tetor 2013

Në çështjen juridike të

M.N

Paraqitësi i kërkesës/Pala ankuese

Kundër

K.K

Pala përgjegjëse në kërkesë/ Pala përgjegjëse në ankesë

Kolegji i Apelit të AKP-së, i Gjykatës Supreme të Kosovës, i përbërë nga gjyqtarët Elka Filcheva-Ermenkova, Kryetare e Kolegjit, Dag Brathole dhe Sylejman Nuredini, anëtarë, duke vendosur në lidhje me ankesën kundër vendimit të Komisionit për Kërkesa Pronësore të Kosovës KPCC/D/R/156/2012 (lënda e regjistruara në AKP me numër KPA 00375), të datës 6 qershor 2012, pas shqyrtimit të mbajtur më 17 tetor 2013, mori këtë

AKTGJYKIM

- 1- **Refuzohet si e pabazuar ankesa e M.N.**
- 2- **Konfirmohet vendimi KPCC/D/R/156/2012 (lënda e regjistruara në AKP me numër KPA 00375), i datës 6 qershor 2012.**
- 3- **Obligohet pala ankuese që t'i paguajë shpenzimet e procedurës në shumën prej 60 € (gjashtëdhjetë euro) brenda afatit prej 15 (nëntëdhjetë) ditësh nga dita e dorëzimit të këtij aktgjykimit nën kërcënimin e përmbarrimit të detyrueshëm.**

Përmbledhja e çështjeve procedurale dhe faktike:

Më 9 mars 2007, M.N (paraqitësi i kërkesës) ka paraqitur kërkesë në Agjencinë Kosovare të Pronës, ku ka kërkuar kthimin në posedim të ngastrës të përshkruar si ngastra 537 – tokë ndërtimore Boro Vukmiroviç, Klinë. Paraqitësi i kërkesës ka deklaruar se prona ishte uzurpuar nga K.K.K pa ndonjë kompensim, se prona ishte një dyqan dhe se ai ishte demoluar nga K.K. Prandaj, ai ka kërkuar kthimin e tij në posedim.

Për të mbështetur kërkesën e tij, ai ka paraqitur dokument të ndryshme, në mes tjerash edhe një aktvendim nga K.K për dhënien e pronës shoqërore paraqitësit të kërkesës, ngastrën 537, me sipërfaqe prej 58 m², të datës 9 mars 1997; lejen ndërtimore për ndërtimin e objektit në të njëjtën ngastër, të lëshuar shumë kohë më parë – më 26 mars 1997; një vendim të datës 25 prill 1997 për dhënien e së drejtës së shfrytëzimit të një objekti të karakterit të përkohshëm për restorant paraqitësit të kërkesës; fletën poseduese të vitit 2005, e cila përshkruan ngastrën në fjalë si pronë shoqërore; kopjen e planit kadastral për të njëjtën ngastër.

AKP-ja ka bërë njoftimin e kërkesës duke vendosur një afishe në ngastër më 23 mars 2007. Më vonë, më 1 korrik 2010, AKP-ja ka kryer njoftimin e dytë me anë të publikimit në gazetën e njoftimeve të AKP-së. Më 30 gusht 2010, Y.M e ka nënshkruar njoftimin për pjesëmarrje në procedurë në emër të K.K. Pala përgjegjëse në kërkesë ka kërkuar të drejtën ligjore ndaj pronës në fjalë.

Me vendimin grupor KPCC/D/R/156/2012 (lënda e regjistruara në AKP me numër KPA 00375), të datës 6 qershor 2012, Komisioni e ka hedhur poshtë kërkesën pasi që ajo nuk është në mandat të tij sipas nenit 3.1 të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50 të ndryshuar me Ligjin nr. 03/L-079. Komisioni ka vërejtur se humbja e posedimit nuk ishte e ndërlidhur me konfliktin e armatosur të viteve 1998-1999.

Nga pikëpamja faktuale e që nuk është kontestuar as nga paraqitësi i kërkesës, ishte vërtetuar se në vitin 1989, komunal i kishte dhënë leje paraqitësit të tanishëm të kërkesës për të ndërtuar një objekt të karakterit të përkohshëm në ngastrën 537 me sipërfaqe prej 58 m². Po ashtu është e qartë se paraqitësi i kërkesës e kishte ndërtuar një hotel dhe e kishte përdorur atë si të tillë pandërprerë deri në vitin 2005 kur komuna e kishte demoluar atë dhe paraqitësit të kërkesës ia kishte revokuar të drejtën e shfrytëzimit dhe posedimit të ngastrës.

Nuk ka kurrfarë dyshimi se pushimi i posedimit apo i shfrytëzimit të paraqitësit të kërkesës nuk është fare i ndërlidhur me konfliktin e armatosur të viteve 1998/1999. Posedimi apo shfrytëzimi i ngastrës nga ai kishte vazhduar deri në vitin 2005.

Paraqitësi i kërkesës ishte njoftuar për vendimin më 14 shkurt 2013.

Më 19 shkurt 2013, ai ka paraqitur ankesë kundër vendimit të lartpërmendur në Gjykatën Supreme.

Pala ankuese pohon se shfrytëzimi i përhershëm i pronës shoqërore është i barabartë me pronësinë si e drejtë absolute. Përveç kësaj, paraqitësi i kërkesës pretendon se vendimi bazohet në vërtetime e gabuar dhe jo të plotë të provave. Prokuroria kompetente i e ka pushuar procedurën e imagjinuar kriminale të iniciuar nga komuna.

Arsyetim ligjor:

Ankesa është e pranueshme. Ajo është paraqitur brenda fatit prej 30 ditësh të paraparë me nenin 12.1 të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50 të ndryshuar me Ligjin nr. 03/L-079.

Megjithatë, ankesa është e pabazuar. Vendimi i KKPK-së është i drejtë, ndërsa rasti nuk është në juridiksion të KKPK-së.

Sipas nenit 3.1 Rregullores së UNMIK-ut 2006/50 të ndryshuar me Ligjin nr. 03/L-079, paraqitësi i kërkesës ka të drejtë në një urdhër nga Komisioni për kthim në posedim të pronës nëse paraqitësi i kërkesës dëshmon jo vetëm pronësinë e pronës së paluajtshme private, por edhe që ai tani nuk është në gjendje që t'i ushtrojë këto të drejta pronësore për shkak të rrethanave që ndërlidhen drejtpërsëdrejti apo që rezultojnë nga konflikti i armatosur që ka ndodhur në Kosovë ndërmjet 27 shkurtit 1998 dhe 20 qershorit 1999.

Sipas nenit 2.1 të Urdhërësës Administrative 2007/5 të ndryshuar me Ligjin 03/L-079 “Çdo person i cili **ka pasur** të drejtë të pronësisë, posedim ligjor apo çfarëdo të drejte tjetër ligjore të shfrytëzimit të pronës

së paluajtshme private, i cili në momentin e paraqitjes së kërkesës nuk mund të ushtrojë të drejtën e tij/saj pronësore për shkak të rrethanave që janë të ndërlidhura drejtpërsëdrejti apo që janë pasojë e konfliktit të armatosur që ndodhi ndërmjet 27 shkurtit 1998 dhe 20 qershorit 1999, ka të drejtë rikthimi të së drejtës pronësore, si bartës i së drejtës pronësore”.

Prandaj çfarëdo e drejtë pronësore, e cila është ndërprerë pas konfliktit e që nuk ka lidhje më të – sikurse kjo në rastin e tanishëm – paraqitësi i kërkesës ishte në posedim/shfrytëzim të saj deri në vitin 2005, duhet të shqyrtohet sipas mekanizmave të procedurës së rregullt civile në kuadër të sistemit të gjykatave të rregullta civile. E njëjta gjë vlen edhe për kërkesat për kompensim të mundshëm.

Paraqitësi i kërkesës/pala ankuese nuk e kundërshton faktin se kishte qenë në posedim dhe shfrytëzim të objektit në fjalë (si dhe të ngastrës në të cilën ai ishte ndërtuar) deri në vitin 2005. Prandaj, ai nuk mund të pretendojë humbja e ndonjë “të drejte pronësore kishte ndodhur për shkak të rrethanave që ndërlidhen drejtpërsëdrejti apo që rezultojnë nga konflikti i armatosur që ka ndodhur në Kosovë ndërmjet 27 shkurtit 1998 dhe 20 qershorit 1999”.

Pasi që kërkesa nuk është në juridiksion të KKPK-së, Komisionit nuk i është dashur të vendos lidhru me pronësinë e palës ankuese.

Duke ndjekur të njëjtën linjë veprimi, për shkak të mungesës së juridiksionit, Gjykatat nuk duhet të vendos nëse pala ankuese është ose jo pronar i pronës së kërkuar.

Obiter dicta:

Për procedurën aktuale nuk është relevante nëse paraqitësi i kërkesës ende e ka të drejtën e shfrytëzimit, kjo do të ishte relevante për padinë pronësore tradicionale/të drejtat pronësore e jo për rastin aktual i cili kufizohet në të drejtat pronësore/të shfrytëzimit të humbur për shkak të luftës së viteve 1998/1999.

Po ashtu nuk është relevante nëse në vitin 2005, pala përgjegjëse në kërkesë kishte të drejtë që të demolojë objektin/ndërtimin. Po që se veprimet e palës përgjegjëse në kërkesë ishin të paligjshme, mënyra për të kërkuar kompensimin është në kuadër të negociatave ndërmjet atij që supozohet ta ketë shkaktuar dëmin dhe atij që supozohet ta ketë pësuar dëmin. Në rast se marrëveshja reciproke është e pamundur, padia civile për kompensim të dëmit do të ishte si alternativë për këtë. Megjithatë, metoda më e përshtatshme për zgjidhjen e kontekstit është ajo që do të përzgjidhet nga vetë pala e dëmtuar. Në lëndë ka të dhëna se paraqitësi i kërkesë tashmë është duke ndjekur padi për kompensim kundër palës përgjegjëse në kërkesë në gjykata të rregullta civile.

Shpenzimet e procedurës:

Në përputhje me Shtojcën III, nenin 8.4 të Urdhërësës Administrative (UA) 2007/5 të ndryshuar me Ligjin nr. 03/L-079, palët lirohen nga shpenzimet e procedurës para Sekretarisë Ekzekutive dhe Komisionit. Megjithatë, një përjashtim i tillë nuk është i paraparë për procedurat para Kolegjit të Apelit. Si pasojë, zbatohet regjimi normal i pagesës së taksave gjyqësore i paraparë më Ligjin për Taksat Gjyqësore (Gazeta Zyrtare e KSAK-së, 3 tetor 1987) dhe me UA nr. 2008/2 të Këshillit Gjyqësor të Kosovës mbi unifikimin e taksave gjyqësore për procedurat para Kolegjit të Apelit.

Kështu që, taksat e mëposhtme të gjykatës zbatohen për procedurat aktuale të apelit:

- Tarifa nga taksa gjyqësore për paraqitjen e ankesës (neni 10.11 i UA 2008/2): 30 €
- Tarifa nga taksa për nxjerrjen e aktgjykimit (neni 10.21, 10.15 dhe 10.1 të UA 2008/20): 30 €.

Këto taksa gjyqësore do të merren përsipër nga pala ankuese e cila duhet t'i paguajë ato brenda afatit prej 15 ditësh nga dita e marrjes së aktgjykimit.

Udhëzim juridik

Sipas nenit 13.6 të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50 të ndryshuar me Ligjin nr. 03/L-079, ky aktgjykim është i formës së prerë dhe nuk mund të kundërshtohet me mjete të rregullta dhe ato jashtëzakonshme juridike.

Elka Filcheva-Ermenkova, Kryetare e Kolegjit, EULEX

Dag Brathole, Gjyqtar i EULEX-it

Sylejman Nuredini, Gjyqtar

Urs Nufer, Referent i EULEX-it